



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 952/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muharrem Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fatos Çeku, kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Pejë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër publikimit të raportit preliminar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Fatos Çeku, kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Pejë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 21.11.2013, nga Fatos Çeku, kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë në Pejë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendohet se ka pas keqpërdorim të votave gjatë numërimit, favorizim i personave tjerë brenda listës tonë, komisioneret e subjektit politik PDK, për Qendrat e Vendvotimeve (QV) si më poshtë: 1725C, 1727C, 1701C, 1702C, 1704C, 1704Y, 1710C, 1711C, 1712C .

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultatet preliminarë në vendvotim është dashtë të parashtrohet në


PZAP nga anëtarët e komisionit të vendotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrës ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 952/2013 më datën 21.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.